




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i biznesit: Zeqir Mehmetaj B.I.
Emri Tregtar: N.P.SH. "Meshari"
Numri Unik Identifikues: 810291914
Pronar: Zeqir Mehmetaj
OSHMA: Radio FONTANA
Adresa: Rr/ Ibrahim Rugova, Istog



VENDIM

për ripërtëritjen e licencës të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audio – Radio Fontana, me seli në Istog

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. Radio Fontana është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio me mbulim lokal, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetim tokësor analog të programeve të radios, me seli në Istog. KPM, me vendimin e datës 28 gusht 2016, lëshimin e licencës së Radio Fontana për një afat prej shtatë (7) vitesh, ndërsa më datën 28 gusht 2023, skadon afati i licencës së Radio Fontana .
3. Me datën 18 prill 2023, KPM përmes e-mail ju ka dërguar shkresë të gjitha radiove të cilave afti i licencës ju skadon licenca në vitin 2023, në mesin e tyre edhe Radio Fontana përmes së cilës shkresë i ka njoftuar lidhur me skadimin e afatit të licencës dhe mundësin e ripërtëritjes së saj në pajtim me Nenin 25 të Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur të Mediave.
4. Më datën 07 korrik 2023, Radio Fontana ka dorëzuar kërkesë me shkrim në Zyrën Ekzekutive të KPM-së, përmes së cilës ka kërkuar ripërtëritjen e licencës.

Arsyetim

5. Neni 25 i Ligjit të KPM-së përcakton: *Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritjet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audio vizuel privat për sa u përket kushteve dhe kriterëve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Komisioni brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.*

6. Me anë të shkresës së datës 18 prill 2023, lidhur me njoftimin për skadimin e afatit të licencës, KPM gjithashtu, ka njoftuar Radio Fontana lidhur me dokumentacionin e nevojshëm për ripërtëritjen e licencës.
7. Komisioni konstaton se, Radio Fontana përmes kërkesës me shkrim ka shprehur interesim për vazhdimin e veprimtarisë së ofrimit të shërbimeve mediale audio (radio) në lokacionin për të cilin është licencuar.
8. Komisioni konsideron se nuk janë evidentuar shkelja të tilla të dispozitave materiale të Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, nga ana e ofruesit të shërbimit medial, të Radio Fontana të cilat shkelje do të pamundësonin ripërtëritje e licencës.
9. Komisioni konstaton se Radio Fontana ka shlyer të gjitha obligimet financiare ndaj KPM - së, përfshirë këtu edhe pagesën e tarifës administrative për ripërtëritje të licencës, e paraparë me Rregulloren KPM-2017/06.
10. Komisioni konstaton se sipas verifikimit në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK), përmes të dhënave mbi bizneset që mund të shihen në faqen e internetit të kësaj agjencie, nuk ka ndryshim të pronësisë së Fontana.
11. Komisioni vlerëson se kërkesa për ripërtëritjen e licencës së Radio Fontana është dorëzuar në pajtim me dispozitat ligjore të parapara me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë kërkesa për ripërtëritjen e licencës së Radio Fontana i plotëson kushtet për miratim dhe se ripërtëritja e licencës është në interesin e publikut në zonën në të cilën transmeton kjo radio.

Vendim

12. Komisioni merr vendim për ripërtëritjen e licencës së Radio Fontana për vazhdimin e veprimtarisë të ofrimit të shërbimeve mediale audio, e cila është në interes të publikut në lokacionin për të cilin është licencuar dhe është duke transmetuar program Radio Fontana.
13. Licenca e Radio Fontana do të jetë e vlefshme për një afat prej shtatë (7) vitesh, ashtu siç është përcaktuar me Nenin 21, paragrafin 2, të Ligjit për KPM-në, ndërsa vlefshmëria e afatit të licencës do të llogaritet nga data 28 gusht 2023.
14. Të gjitha parametrat e licencës së Radio Fontana, siç janë: kategoria e të licencuarit, skema programore, parametrat teknike dhe harta e zonës së mbulimit do të mbesin të pandryshuar nga licenca paraprake.
15. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.


Jeton Mehmeti
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



03.10.2023
Datë